

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**NDIKIMI I THELLËSISË FINANCIARE TEK RITJIA EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË**

*Anxhela Zani<sup>1</sup>*  
*Gerti Mezi<sup>2</sup>*

*Mentore: Prof. Asoc. Dr Brunilda Duraj,*  
*Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës*

**Abstrakt**

Ky punim analizon dhe mat efektet e thellësisë financiare në rritjen ekonomike, e matur nëpërmjet rritjes reale të PBB-së për frymë. Nëpërmjet tij tregojmë rëndësinë që ka zhvillimi i tregjeve financiare në thithjen e kapitaleve të reja, mundësive të tjera të financimit përveç financimit nëpërmjet huave bankare dhe rregullimit të nevojshëm nga autoritetet rregullative për të mbështetur këtë zhvillim. Studimi ynë vlerëson këtë lidhje nëpërmjet modelit VAR për një periudhë nga viti 2000 e deri në 2016. Të dhënat e përdorura janë të dhëna dytësore të marra nga Banka Botërore.

Duke analizuar lidhjen komplekse mes rritjes dhe thellësisë financiare ne shqyrtojmë edhe raportin që ka Shqipëria me vendet e rajonit. Rezultatet tregojnë se ekziston një lidhje e njëanshme ku vërehet se thellësia financiare ndikon tek rritja ekonomike. Këto rezultate janë në të njëjtën linjë me disa nga studimet e kryera nga autorë të huaj. Ajo çfarë tregojnë rezultatet është se duhet të rritet pjesëmarrja e aktorëve në tregjet financiare, kryesisht funksionimi i bursës dhe aplikimi i politikave ndaj kompanive vendase dhe të huaja. Zhvillimi financiar sjell jo vetëm rritje ekonomike dhe përfitime për aktorët më të mëdhenj në treg, por gjithashtu mundëson reduktim të varfërisë dhe ulje të pabarazisë ndërmjet grupeve socio-ekonomike, mundëson alokimin e fondeve në mënyrë produktive, krijon instrumente të nevojshme për mbrojtjen ndaj risqeve dhe zgjeron mundësitë investuese. Shqipëria është relativisht e përgatitur për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve të kapitalit, por ka ende hapësira për përmirësime të mëtejshme.

***Fjalët kyçe:*** *Thellësia financiare, treg financiar, rritje ekonomike, modeli VAR, testi Granger*

---

<sup>1</sup> Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, [zani anxhela@yahoo.com](mailto:zani anxhela@yahoo.com)

<sup>2</sup> Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, [gertimezini@outlook.com](mailto:gertimezini@outlook.com)